



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislacioni -III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 03-2008

Prishtinë, me 4 mars 2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkollli, Džezair Murati.

Të ftuarit: Sherif Konjufca-Zyra për Informim, Ramadan Islami-OSBE, Lejla Selimi-OSBE, Reshit Gashi-NDI, Haxhi Gashi-USAID, Robert Steere-NCSC, Fitore Zeneli-KDI.

Nga staffi i Komisionit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;
3. Shqyrtimi i propozimit të fushëveprimit të Komisionit
4. Shqyrtimi i propozimit të planit të punës së Komisionit
5. Shqyrtimi i propozimit për rregullat e punës së Komisionit
6. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

8. Shqyrtimi i Projektligji për plotësimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale;
9. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kryetari në fillim i përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit e tjerë, pastaj i pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit të fushëveprimit të komisionit

Bahri Hyseni-kryetar i Komisionit, theksoi se në fushëveprim janë përfshirë propozimet e reja nga anëtarët e Komisionit që ata i kanë paraqitur me shkrim. Te propozimi i Prof. Riza Smakës në vijën e dytë të fushëveprimit ku thuhet: “- në raste të caktuara përcakton propozim-ligj, amendament në ligj apo në aktin të cilin e miraton Kuvendi i Kosovës”, fjala “përcakton” ndoshta do të ishte më mirë të ndryshohej. Pas diskutimit të saj në Komision u vendos që kjo fjalë të zëvendësohet me “përkufizon”. Fjala Kushtetutë të shkruhet me shkronjë të madhe. Ndërsa sa i përket pjesës hyrëse të fushëveprimit kryetari propozoi të hiqet krejt pjesa e dytë: “nga aspekti i përgjegjësive të tij për të rregulluar me ligje çështjet e përcaktuara”. Gjithashtu kryetari propozoi që pika numër 2 e fushëveprimit të hiqet, pasi është thënë më lart.

Pas diskutimeve në lidhje me këtë pikë. U pajtua që të gjitha këto propozime për fushëveprim të bëhen nga ana e stafit të Komisionit.

4. Shqyrtimi i propozimit të planit të punës së Komisionit

Kryetari-theksoi se stafi i Komisionit fillimisht kishte hartuar një plan të punës që me pas me pranimin e strategjisë legjislative të Qeverisë është plotësuar. Janë shfaqur disa probleme në lidhje me caktimin e datave për shqyrtimin e këtyre projektligjeve. Kryetari shtoi se ky projekt-propozim ka mundësi të ndryshohet dhe mund të përfshihet ndonjë vizitë apo aktivitet tjetër në të.

Adem Hajdaraj-theksoi se tash për tash ky projekt-propozim është në rregull dhe u pajtua që të miratohet në parim, ndërsa më vonë gjatë punës mund të shtohet edhe diçka në të.

Riza Smaka-paraqiti vërejtjet e tij duke filluar që nga faqja e parë e planit të punës, pika numër 5 e tij propozoi të hiqet fjala “shtetërore”, sepse me fjalën Republikë nënkuptohet

se bëhet fjalë për institucionet shtetërore dhe te pika numër 6: aty ku përmenden organizatat ndërkombëtare të bëhen shtesat: -i dhe -ja. Ai më tutje në fjalën e tij propozoi të formohet një komision hetimor në lidhje me Trustin Pensional të Kosovës, duke i pasur parasysh shumë çështje të cilat ndërlidhen me këtë trust dhe veçanërisht diferencat e kamatave që shkojnë diku tjetër, si dhe mungesën e transparencës, pagat marramendëse të udhëheqësve të trustit gjithmonë duke e pasur parasysh se këto janë para të pensionistëve. Ai gjithashtu propozoi që Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ta fillojë punën për hartimin e Projektligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

Selviqe Halimi-theksoi se në lidhje me hartimin e këtij projektligji duhet të bashkëpunohet edhe me Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Pas diskutimit të kryetarit dhe Riza Smakës u pajtua që të konsultohet edhe Kryetari i Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Pas diskutimeve për këtë pikë u konstatua se:

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do ta hartojë projektligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, në bashkëpunim me Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Komisioni pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, njëzëri miratoi Planin e Punës së Komisionit.

5. Shqyrtimi i propozimit për rregullat e punës së Komisionit

Kryetari-theksoi se këto rregulla të hartuara nga NDI-ja nuk duhet t'i shërbejnë vetëm Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi por edhe Komisioneve të tjera të Kuvendit të Kosovës.

Adem Salihaj-theksoi se NDI-ja ka bërë një punë të mirë dhe u pajtua që këto rregulla të miratohen nga ana e Komisionit dhe, gjithashtu, propozoi që këto rregulla t'i dërgohen edhe Komisionit për Rregulloren e Punës për t'i marrë sugjerimet nga ai komision. Kryetari propozoi që pas miratimit në parim këto rregulla t'i dërgohen edhe Kryesisë së Kuvendit që do të mund ta jepte edhe miratimin që këto të përdoren edhe nga komisionet e tjera, pra të bëhet një formë unike.

Reshit Gashi-nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) e mori fjalën dhe prezantoi në lidhje me punën që është bërë gjatë hartimit të këtyre rregullave duke shpjeguar se në hartimin e këtyre rregullave kanë marrë pjesë ekspertë amerikanë dhe kanadezë. Ai më tutje sqaroi disa nga rregullat e reja të propozuara që kanë të bëjnë me: mbledhjet e mbyllura, me dëgjimet publike, me raportimin si dhe me mundësinë e pasjes së një buxheti të veçantë për të angazhuar ekspertë ligjorë, çështjen e votimit etj.

Pas prezantimit të përfaqësuesit të NDI-së diskutuan Bajram Kosumi, Riza Smaka Adem Hajdaraj dhe kryetari. **Kryetari** propozoi që te rregulla numër 4. votimi, sa u përket mbledhjeve të mbyllura, të hiqet krejt, sepse nuk ka mbledhje të mbyllur. Te rregulla 8. dëgjimet publike, të dihet se të gjithë jemi të barabartë, ndërsa te rregulla 9 pika b), fjala “*dëshmitarëve*” duhet të zëvendësohet me “*ekspertë*”, ndërsa te rregulla 10 të hiqet krejt

pika l), sepse nuk është e nevojshme. Te rregulla 9 pika f), fjala “nën-amendamente”, duhet të hiqet, sepse ne si komision bëjmë vetëm amendamente dhe gjithashtu te rregulla 10 pika l) të hiqet sepse nuk është e nevojshme.

Riza Smaka-propozoi të mos përdoret fjala “amandament”, por gjithmonë fjala “amendament”. Ai gjithashtu propozoi që në vend të “rregullave” të thuhet “nene”, ndërsa pikat a,b,c të zëvendësohen me “paragrafë” apo “nënparagrafë”. Fjala “nën-komision” të zëvendësohet me “komitet” apo “grup punues”.

Pas diskutimeve në lidhje me këtë pikë, njëzëri u miratuan në parim Rregullat e Punës dhe u vendos që stafi i Komisionit së bashku me përfaqësuesin e NDI-së, të hartojnë projektin përfundimtar.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës

Në lidhje me këtë pikë, kryetari propozoi që të mos caktohet raportuesi, pasi janë vetëm dy nene për t’u shqyrtuar.

Adem Salihaj-propozoi që në nenin 1 apo 2 të këtij projektligji të thuhet Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe të mos thuhet më i përkohshëm. Pas diskutimit të kryetarit, Riza Smakës dhe Adem Salihajt u pajtua se fjala i përkohshëm kishte ardhur si shkak i mosgjydhjes së statusit dhe i insistimit të ndërkombëtarëve.

Riza Smaka-paraqiti vërejtjen e tij në lidhje me nenin 1 të Projektligjit dhe shpjegoi se një nen të tillë nuk do të duhej miratuar për shkak se në vendin tonë jemi shumë të ndjeshëm ndaj këtyre çështjeve që mund të ngritën pikërisht nga ky nen. Bajram Kosumi dhe Adem Salihaj u shprehën në favor të miratimit në parim të këtij neni. Ndërsa Ramadan Gashi gjithashtu u shpreh kundër miratimit të këtij neni. Ndërsa sa i përket ndryshimit të emrit një mundësi do të ishte ndryshimi i emrit të Kodit me amendament për plotësim dhe ndryshim apo me mundësinë e paraqitjes së kërkesës Kryesisë së Kuvendit për ndryshimin e emrave edhe të shumë ligjeve të tjera. Më pas diskutuan: Selvije Halimi, Adem Hajrdaraj dhe Adem Salihaj.

U konstatua se çështja e ndryshimit të emrit do të ngritet edhe për shkak se pas këtij do të kemi edhe dy ligje të tjera të natyrës së tillë.

Riza Smaka-gjithashtu propozoi që në nenin 1 të këtij projektligji tek fjala “do të shqiptojë një dënim” duhet ndryshuar me “mund të shqiptojë një dënim”. Me këtë propozim u pajtua Ramadan Gashi dhe gjithashtu këshilltari nga NDI, Haxhi Gashi, u shpreh se më mirë do të ishte të jetë: “mund të”.

Pas këtyre diskutimeve me shumicë u miratua neni 1 i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës. Kundër miratimit të këtij projektligji votuan Riza Smaka dhe Ramadan Gashi, ndërsa abstenoj Adem Hajrdaraj.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të

përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

Kryetari-propozoi të caktohet një raportues për këtë projektligj dhe, gjithashtu, duhet të ftohet edhe sponsori i këtij projektligji që t'ia prezantojë Komisionit.

Adem Salihaj-theksoi së është i gatshëm të raportojë pasi që ka përgatitur edhe vërejtje konkrete së bashku me juristë.

Njëzëri u miratua propozimi që raportues të caktohet Adem Salihaj dhe që pas një jave të raportojë në lidhje me këtë projektligj, gjithashtu t'i bëhet ftesë edhe Ministrin për të prezantuar në të njëjtën ditë.

8. Shqyrtimi i Projektligji për plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;

Kryetari-tha sa i përket këtij projektligji ai është i gatshëm të raportojë nëse nuk ka ndonjë propozim tjetër.

Njëzëri u miratua që raportues të caktohet Bahri Hyseni dhe që pas një jave të raportojë në lidhje me këtë projektligj dhe gjithashtu të dëgjohen ekspertë.

9. Të ndryshme

Adem Salihaj-propozoi të organizohen takime dy herë në javë sepse kemi shumë projektligje për të shqyrtuar. Propozim i tij është p.sh. edhe dita e premte ora 10:00.

Kryetari-u pajtua dhe shtoi se duhet t'i marrim të gjitha projektligjet dhe të shqyrtohet baza e tyre kushtetuese dhe gjithashtu të caktojmë raportues për projektligjet për të cilat Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi është funksional.

Propozimi u miratua njëzëshëm.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbalin e hartoi:
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni